



## **VENDIM PËR HEQJEN E ANKESËS NGA LISTA**

**Data e miratimit: 27 qershor 2016**

**Numri i lëndës: 2014-39**

**Musli Hyseni**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 27 qershor 2016, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga:  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtar ligjor  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar me 13 tetor 2014. Për shkak të dorëheqjes së znj. Katja Dominik si anëtare e Panelit, pas shqyrtimit ajo u zëvendësua nga znj. Elka Filcheva-Ermenkova, anëtare

zëvendësuese e Panelit, në përputhje me rregullin 14 par. 2 të rregullores së punës.

## II. FAKTET

2. Faktet e lëndës, siç janë paraqitur nga ankuesi mund të përmbliidhen si më poshtë.
3. Ankuesi ishte arrestuar me 5 nëntor 2013 në shtëpinë e tij në fshatin Bresalc, nën dyshimin e veprave penale në vijim:
  - Vepra penale e përgatitjes së aktiviteteve terroriste apo vepra penale e kryer në bashkëpunim siç parashihet me nenin 144 (1) të KPK-së, në lidhje me nenin 31 të KPK-së, e dënueshme me gjobë dhe me 1 deri në 5 vjet burgim.
  - Vepra penale e pjesëmarrjes në një grup terrorist siç parashihet me nenin 143 (2) të KPPK-së në lidhje me nenin 135 (4) të KPPK-së, e dënueshme 5 deri në 10 vjet burgim.
  - Vepra penale e blerjes së paautorizuar të armëve, siç saktësohet në nenin 372 (2) të KPPK-së, e dënueshme me 1 deri në 10 vjet burgim.
  - Vepra penale e nxitjes së urrejtjes, përçarjes apo mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik siç parashihet me nenin 147 (1) të KPPK-së, e dënueshme me gjobë ose deri me 5 vjet burgim.
4. Arrestimi i ankuesit u pasua nga një operacion policor. Nga prokurori ishte pretenduar se ankuesi kishte qenë i pranishëm dhe në shoqërinë e një të bashkakuzuari (në një automjet). I bashkakuzuari ishte duke u përpjekur për të negociuar blerjen e armëve. Prokurori është informuar nga policia se ankuesi ishte identifikuar prej tyre si një prej personave të pranishëm në automjet gjatë transaksionit në tentativë. Prokurori pretendoj se ankuesi ishte në dijeni rreth qëllimit të takimit.
5. Me vendimin e datës 7 nëntor 2013, gjykatësi i procedurës paraprake të Gjykatës Themelore të Prishtinës ka urdhëruar paraburgimin e ankuesit për një muaj.
6. Përmes disa urdhrave pasues të ngjashëm, ankuesi ka vazhduar të mbahej në paraburgim deri me 15 tetor 2014. Ankuesi ka paraqitur ankesën e tij në Panel nga Qendra e Paraburgimit të Prizrenit, me 13 tetor 2014.

### III. ANKESAT

7. Ankuesi pohon se janë shkelur të drejtat e tij për liri dhe siguri sipas nenit 5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.
8. Ankuesi pohon se përderisa ishte i pranishëm dhe në shoqërinë e një bashkë të akuzuarit në momentin në fjalë, ai nuk ishte në dijeni të qëllimit të takimit të mbajtur me palën e tretë.
9. Ankuesi pohon se është i pafajshëm rreth akuzave të parashtruara kundër tij nga prokurori dhe pohon se është mbajtur padrejtësisht në paraburgim për gati një vit.

### IV. LIGJI

10. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
11. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
12. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtoj ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
13. Paneli thekson se ankesa e ankuesit në thelb ka të bëjë me një numër vendimesh nga gjykatësi i procedurës paraprake rreth urdhrin për t'i vazhduar atij paraburgimin gjatë një periudhe prej 7 nëntorit 2013 deri me 15 tetor 2014.
14. Me 7 mars 2016, Paneli ka komunikuar me ankuesin duke kërkuar nga ai një informatë prej tij në lidhje me faktet e çështjes, në veçanti në lidhje me statusin e paraburgimit të tij, duke pasur parasysh se vendimi i fundit i Gjykatës Themelore të Prishtinës në dispozicion të Panelit ishte i datës 31 korrik 2014. Ankuesi ishte njoftuar se nëse ka ndonjë parashtrës të tij duhet të dorëzohen në Panel jo më larg se data 1 prill 2016.

15. Më tutje Paneli nuk ka marrë asnjë përgjigje me shkrim nga ankuesi në kërkesën e tij të datës 7 mars 2016.
16. Më 11 prill 2016, ankuesi ka kontaktuar Sekretariatit e Panelit dhe ka treguar se nuk dëshiron që më të vazhdoj ankesën e tij dhe se ishte liruar nga paraburgimi. Ai nuk ofroj hollësi të tjera Sekretariatit.
17. Rregulla 29 e *tutje* parasheh që Paneli në çdo fazë të procesit mund të vendos ta heqë ndonjë ankesë nga lista e lëndëve, atëherë kur rrethanat çojnë në përfundimin se parashtruesi i ankesës nuk ka ndërmend të vazhdoj ankesën e tij/saj.
18. Duke vënë në dukje mosgatishmërinë e parashtruesit të ankesës për të vazhduar me ankesën e tij, Paneli është i mendimit se ankesa nuk duhet më të shqyrtohet.

**PËR KËTË ARSYE**, Paneli njëzëri,

*vendos ta heq këtë ankesë nga lista e lëndëve, në pajtim me rregullën 29 e tutje, paragrafin 1(a) të rregullores së punës.*

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese